



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**



**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2022

Prishtinë, shkurt 2022

Hyrje

Ky plan i punës bazohet në mandatin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, dhe si i tillë është hartuar në pajtim me prioritetet dhe objektivat e përcaktuara, me qëllim të realizimit sa më efikas të mandatit të Agjencisë. Përmes prioriteteve dhe objektivave të strukturuar përmes këtij plani, Agjencia synon të avancojë aktivitetet dhe rezultatet e Agjencisë Kundër Korrupsionit në fushat më me prioritet. Plani i punës së Agjencisë për vitin 2022 është fokusuar në objektiva si dhe aktivitete specifike për secilën objektivë, realizimi i të cilave është parashikuar përmes indikatorëve apo treguesve, me rezultate të matshme dhe të arritshme duke përcaktuar masa konkrete dhe afate për secilin aktivitet.

Agjencia Kundër Korrupsionit planin e saj të punës e ka fokusuar kryesisht në objektiva me prioritet si dhe objektiva që realizohen në vazhdimësi, me të cilat synon fuqizimin e institucionit me qëllim të përbushjes së plotë të misionit të saj drejtë parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

Përshkrimi i Institucionit

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, AKK është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Agjencia është themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa është funksionalizuar më 12 shkurt 2007.

Fushëveprimi i Agjencisë është i përqendruar në hetimet dhe aspektet administrative. Këtë mandat AKK e realizon përmes procesit të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, deklarimit dhe regjistrimit të dhuratave të zyrtarëve publik, parandalimit të rasteve të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, hetimin dhe zbulimin e rasteve me natyrë të korrupsionit, mbrojtjen e sinjalizuesve, përpjekjet për parandalimin e fenomenit të korrupsionit si dhe vetëdijesimin e publikut në hapat progresiv drejt krijimit të një shoqërie ku sundon rendi dhe ligji.

Legjislacioni aktual kundër korrupsionit, mbi bazën e të cilit AKK edhe i zhvillon aktivitetet e saj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, në mbrojtjen e sinjalizuesve, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, jo pajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Korniza ligjore

Gjatë realizimit të mandatit dhe ushtrimit të kompetencave, AKK bazohet në kornizën ligjore primare dhe sekondare. Korniza ligjore primare bazike, por që nuk kufizohet vetëm, sipas së cilës AKK realizon mandatin është si në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Ligji Nr. 04-L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar;
- Ligji Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04-L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të personat zyrtar;
- Ligji Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
- Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Aktet nën-ligjore në bazë të të cilave është organizuar puna e AKK dhe të cilat janë të miratuara nga AKK janë si në vijim:

- Rregullorja Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Kodi Nr. 03/2013 i etikës për nëpunësit e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullorja Nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

- Rregullorja Nr. 02/2014 për organizimin, funksionalizimin dhe menaxhimin e arkivit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullorja Nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullorja Nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Organizimi i brendshëm

Agjencia ka të punësuar 43 zyrtarë, duke përfshirë Drejtorin e Agjencisë. Organizimi i brendshëm është i rregulluar me Rregulloren Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Rregullores Nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Sipas kësaj Rregullore, Agjencia është e ndarë në këto departamente dhe divizione:

1. **Departamenti për Luftimin e Korrupsionit** është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të hetimit paraprak të rasteve të dyshimit për korrupsion, analizimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për gjendjen e korrupsionit në Kosovë, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, mbrojtjen e sinjalizuesve sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe raportimin për zbatimin e detyrave të Agjencisë të përcaktuara nga dokumentet tjera strategjike. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Hetime dhe Analiza, 2. Divizioni për Hetime dhe Strategji, dhe 3. Divizioni për Mbrojtjen e Sinjalizuesve,
2. **Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit** është përgjegjës për mbikëqyrjen e pasurisë, mbikëqyrjen e dhuratave dhe parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe korrupsionit në tërësi. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave dhe 2. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik,
3. **Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit** është përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik, bashkëpunon me Autoritetet Përgjegjëse, merret me analizimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, pranon raportet vjetore nga Autoritetet Përgjegjëse, ofron asistencë profesionale dhe këshilla për institucionet tjera në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Zyrtarë të Lartë dhe Autoritete Përgjegjëse, dhe 2. Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Autoritete Përgjegjëse dhe Personat Zyrtarë,
4. **Departamenti për Financa dhe Punët të Përgjithshme** është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen për burimet materiale, ofrimin e shërbimeve administrative, menaxhimin e financave dhe buxhetit si dhe logjistikën e Agjencisë. Ky Departament është i përbërë nga Divizioni për Shërbime të Përgjithshme, Buxhet dhe Financa,
5. **Zyrën për Mbështetje dhe Bashkëpunim** është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale, për menaxhimin dhe administrimin e të dhënave elektronike të agjencisë dhe të sistemit të TI-së, dhe çështjet tekniko-administrative dhe arkivimin e shkresave zyrtare,

6. **Koordinatori i Zyrës për Komunikim me publikun** organizon, koordinon, drejton dhe bashkërendon aktivitetet lidhur me informimin e publikut dhe mediave përkitazi me punën, aktivitetet dhe veprimtarinë e Agjencisë,
7. **Menaxheri i personelit** përgjegjës për proceduat e rekrutimit, dhe
8. **Menaxheri Prokurimit** përgjegjës për menaxhimin e disa aktiviteteve të prokurimit.

Procesi i hartimit të Planit të Punës - Metodologjia

Menaxhmenti i Agjencinë kundër Korrupsionit në muajin janar të vitit 2022, ka mbajtur një seri takimesh pune ku të gjitha njësitë e Agjencisë kanë raportuar për përmbushjen e Planit Vjetor të Punës për vitin 2021 dhe identifikuar aktivitetet që mund të zbatohen edhe në vitin 2022.

Më tej, Menaxhmenti i AKK-së nga data 07 deri me 10 shkurt 2022, ka mbajtur një punëtori, me prezencën edhe të përfaqësuesit nga Projekti i SAEK III ku janë diskutuar dhe përmbledhur aktivitetet që AKK duhet të kryej në vitin 2022 për të zbatuar mandatin e vet.

Plani i punës i Agjencisë Kundër Korrupsionit është i organizuar në tetë fusha dhe secili aktivitet ka titullin, përshkrimin e shkurtër të aktivitetit, njësia përgjegjëse dhe personi përgjegjës për zbatim, afatin kohor të zbatimit, duke përfshirë edhe periudhat kur do raportohet, treguesit e performancës dhe një vlerësim të përafërt resurseve (kostos dhe burimit të buxhetit) kudo që mund të zbatohet.

Plani i punës është i orientuar në tetë (8) fusha me pesëdhjetë e tri (53) aktivitete gjegjëse që do kontribuojnë në realizimin e mandatit të Agjencisë:

- 1) Fuqizimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit me gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete;
- 2) Deklarimi, regjistrimi dhe kontrolli i pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë me shtatë (7) aktivitete;
- 3) Zhvillimi i procedurës së hetimeve paraprake nga Agjencia me katër (4) aktivitete;
- 4) Shqyrtimi i rasteve të konfliktit të interesit me pesë (5) aktivitete;
- 5) Mbrojtja e Sinjalizuesve me katër (4) aktivitete;
- 6) Avancimi i teknologjisë informative për Agjencinë me katër (4) aktivitete;
- 7) Monitorimi nga Agjencia me tri (3) aktivitete;
- 8) Menaxhimi i Buxhetit dhe i Burimeve Njerëzore me dhjetë (10) aktivitete.

Plani i Punës është edhe operacionalizim i Planit të Performancës i dorëzuar dhe aprovuar nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit i Kuvendit të Kosovës.

1 Fuqizimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit																				
Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia përgjegjëse	Personi përgjegjës	Afati Kohor												Raportimi	Treguesit e performancës	Vlerësimi i resurseve	
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi
1.1	Pjesëmarrja në Rishikimin e Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit	Meqenëse projektligji është në fazën finale të aprovimit në Kuvendin e Kosovës, Agjencia do të merr pjesë në takimet e grupit punues dhe do të ofroj kontributin e vet profesional.	AKK	Drejtori I AKK													Sipas pjesëmarrjes në takime	1. Numri i takimeve të mbajtura, 2. kontributi i dhënë nga Agjencia, 3. Ligji i miratuar	Pa kosto shtesë	
1.2	Pjesëmarrja në Rishikimin e ligjit për deklarimin e pasurisë dhe pjesëmarrja në grupe punuese në hartimin e projekt ligjit	Meqenëse projektligji është në fazën finale të aprovimit në Kuvendin e Kosovës, Agjencia do të merr pjesë në takimet e grupit punues dhe do të ofroj kontributin e vet profesional.	AKK	Drejtori I AKK													Sipas pjesëmarrjes në takime	1. Numri i takimeve të mbajtura, 2. kontributi i dhënë nga Agjencia, 3. Ligji i miratuar	Pa kosto shtesë	
1.3	Hartimi dhe Miratimi i akteve nënligjore të Agjencisë Kundër Korrupsion	Draftimi dhe miratimi i akteve nën-ligjore të Agjencisë, si dhe akteve tjera nënligjore pas hyrjes në fuqi të ligjeve të reja, ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe ligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, miratimi i akteve nën-ligjore të cilat janë të përcaktuar në këto dy ligje.	AKK	Lindita Ademi													K1, K2, K3	1. Numri akteve nën-ligjore të hartuara, 2. Numri i akteve nën-ligjore të miratuara		Buxheti i AKK dhe Donatori - Projekti SAEK III
1.4	Hartimi i Metodologjisë për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit	Kjo fillohet të zbatohet pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për parandalimin e korrupsionit. Agjencia do të hartoj dhe aprovoj metodologjinë paraprakisht.	AKK	Blerim Kelmendi													K2, K3, K4	1. Metodologjia për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit e hartuar dhe e aprovuar, dhe 2. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit e hartuar dhe e aprovuar		Buxheti i AKK dhe Donatori - Projekti SAEK III
1.5	Hartimi dhe aprovimi i planit për menaxhimin e rreziqeve dhe emergjencave në Agjenci	Mbikëqyrja dhe rifreskimi i planit të menaxhimit të rreziqeve dhe emergjencave, në bashkëpunim dhe bashkëveprim me Departamentet dhe njësitë përkatëse të AKK-së.	BPPB	Bedri Mecini													K1, K2, K3, K4	1. Plani për menaxhimin e rreziqeve të Agjencisë i hartuar dhe i aprovuar		
1.6	Hartimi i Metodologjisë për vlerësimin kundër-korrupsion të akteve ligjore	Kjo fillohet të zbatohet pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për parandalimin e korrupsionit. Agjencia do të hartoj dhe aprovoj metodologjinë paraprakisht.	ZMPB	Lindita Ademi													K1, K2, K3	1. Metodologjia për vlerësimin kundër-korrupsion të akteve ligjore e hartuar dhe e aprovuar		Buxheti i AKK dhe Donatori - Projekti SAEK III
1.7	Hartimi i Metodologjisë për Planet e Integritetit	Kjo fillohet të zbatohet pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për parandalimin e korrupsionit.	DPK	Afrim Atashi													K3, K4	1. Metodologjia për Planet e Integritetit e hartuar dhe e aprovuar		Buxheti i AKK dhe Donatori - Projekti SAEK III

1.13	Bashkëpunimi me institucionet vendore	Agjencia bashkëpunon me institucionet e zbatimit të ligjit dhe institucionet tjera të administratës publike. Kjo bëhet për qëllimet e shkëmbimit të informacioneve në mënyrë që të parandalohet dhe luftohet korrupsioni në mënyrë sa më efikase.	AKK	Drejtori I AKK															K1, K2, K3, K4	1.Numri i takimeve të mbajtura, 2.Numri i komunikimeve të shkëmbyera, 3.Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara		
1.14	Promovimi i rolit dhe mandatit të Agjencisë kundër korrupsionit në publik	Forcimi i llogaridhënës së AKK-së në raport me fushëveprimin për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit që përfshin komunikimin me mediat, organizatat Jo-Qeveritare dhe akterët tjerë relevant të komunikimit. Përgatitja e strategjisë për komunikim publik 2022-2025 dhe lancimi i fushatave informuese për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.	ZD, KM	Lumnije Demi															K1, K2, K3, K4	1. Porosia e Drejtorit të AKK-së; 2. Statistikat e informatave (përgjigjeve) të dërguara në media; 3. Rastet e trajtuara nga AKK, të inciuara nga mediat dhe OJQ-të;		Buxheti i AKK dhe përkrahja e donatorëve
1.15	Hartimi i strategjisë për Komunikim publik 2022-2025 dhe Planit të Veprimit	Hartimi i Strategjisë ka për qëllim forcimin e integritetit të AKK-së në raport me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit nëpërmjet transparencës dhe llogaridhënës.	ZD, KM	Lumnije Demi															K1	1.Strategjia e hartuar; 2.Strategjia e aprovuar; 3.Përgatitja e planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë;		
1.16	Java Kundër Korrupsionit 2022 dhe Dita e Agjencisë	Shënimi i ditës së themelimit të Agjencisë në muajin Korrik. Përfshirja e AKK-së në udhëheqjen e javës kundër Korrupsionit bëhet në bashkëpunim me misionet diplomatike në Kosovë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Institucionet e pavarura dhe Organizatat Jo –Qeveritare.	ZD, KM	Lumnije Demi															K2, K4	1.Plani i veprimit i aprovuar; 2.Rekomandimet e adresuara;		Buxheti i AKK dhe përkrahja e donatorëve

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia përgjegjëse	Personi përgjegjës	Afati Kohor												Raportimi	Treguesit e performancës	Vlerësimi i resurseve	
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi
2.1	Përgatitja e listave finale të deklarimit të pasurisë	Në këtë aktivitet, agjencia do të bëjë unifikimin e listave të deklarimit të pasurisë, e cila do të jetë për vitin 2022.	DPK, KM	Agron Behrami													K1	Lista e përgatitur	Pa Kosto shtesë	
2.2	Pranimi dhe regjistrimi i formularëve të deklarimit të pasurisë	Deklarimi i rregullt bëhet gjatë muajit mars, ndërkaq deklarimet tjera bëhen gjatë gjithë vitit. Regjistrimi i formularëve të deklarimit të rregullt vjetor bëhet gjatë muajit Prill dhe Maj, dhe deklarimet tjera bëhen gjatë gjithë vitit.	DPK	Afrim Atashi													K1, K2, K3, K4	1. Numri i formularëve të pranuar, 2. Regjistrimi i Formularëve të deklarimit të pasurisë	Pa Kosto shtesë	
2.3	Publikimi i listës së zyrtarëve publik në Web-faqen e Agjencisë	Publikimi i listës së zyrtarëve të lartë publik të cilët kanë deklaruar pasurinë dhe zyrtarëve që nuk kanë deklaruar pasurinë sipas ligjit në fuqi.	DPK, KM	Afrim Atashi													K2, K3	1. Lista e përgatitur dhe e publikuar për deklarimin e rregullt vjetor	Pa Kosto shtesë	
2.4	Hedhja e shotit për krijimin e listës për kontrollë të plotë	Organizimi i takimit me medie dhe shoqëri civile në të cilin bëhet hedhja e shortit për të përzgjedhur 20% të zyrtarëve të lartë publik të cilët do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë.	DPK, KM, ZD, ZMBP	Afrim Atashi, Lumnije Demi, Besnik Dragusha													K2, K3	1. Ftesa për medie dhe shoqëri civile, 2. Organizimi i takimit, 3. Krijimi i listës së zyrtarëve të lartë për kontrollë të plotë, 4. Publikimi i listës së 20% që iu nënshtrohet kontrollit të plotë	100	Buxheti AKK
2.5	Kontrolli i Plotë i zyrtarëve të lartë sipas shortit	20% të zyrtarëve të lartë publik të përzgjedhur sipas shortit i nënshtrohen kontrollit të plotë.	DPK	Agron Behrami													K3, K4	1. Numri i zyrtarëve të lartë të cilët iu janë nënshtuar kontrollit të plotë		
2.6	Kontrolli sipas informatave të pranuar	Kontrolli i plotë i cili kryhet nga Agjencia në bazë të informatave të pranuar nga palët e treta.	DPK	Agron Behrami													K1, K2, K3, K4	1. Numri i zyrtarëve të lartë të cilët iu janë nënshtuar kontrollit të plotë	Pa Kosto shtesë	
2.7	Regjistrimi i Katalogut të Dhuratave	Mirëmbajtja e bazës së të dhënave në lidhje me dhuratat e deklaruar të cilat kanë raportuar institucionet e ndryshme publike tek zyrtari përgjegjës për listën e dhuratave.	DPK	Afrim Atashi													K1, K2, K3, K4	1. Lista e katalogut të dhuratave, 2. Mirëmbajtja e Regjistrimit të Katalogut të dhuratave, 3. Publikimi i Listës së Katalogut të Dhuratave	Pa Kosto shtesë	

3 Zhvillimi i procedurës së hetimeve paraprake nga Agjencia																				
Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia përgjegjëse	Personi përgjegjës	Afati Kohor												Raportimi	Treguesit e performancës	Vlerësimi i resurseve	
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi
3.1	Pranimi, Evidentimi dhe përzgjedhja e rasteve për zhvillimin e hetimeve parapake	Agjencia pranon rastet në forma të ndryshme, si nga procesi i deklarimit të pasurisë, konfliktit të interesit dhe nga palët e treta.	DLK	Blerim Kelmendi													Çdo muaj	1. Numri i rasteve të pranuar 2. Numri i rasteve të inicuar 3. Numri i rasteve të cilat kalojnë në procedure të hetimeve	Pa Kosto shtesë	
3.2	Hetimi i rasteve të dyshuara të korrupsionit	Agjencia është përgjegjëse për zhvillimin e hetimeve në rastet e paraqitjes së dyshimit të veprimeve korruptive.	DLK	Blerim Kelmendi													Çdo muaj	1. Numri i rasteve të proceduara, 2. Numri rasteve të mbyllura	Pa Kosto shtesë	
3.3	Paraqitja/ dorëzimi i kallëzimeve penale	Paraqitja e kallëzimeve penale në prokurorinë përkatëse për rastet në të cilat ka rezultuar dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale me elemente të korrupsionit.	DLK	Blerim Kelmendi													Çdo muaj	Numri i kallëzimeve penale të dorëzuar	Pa Kosto shtesë	
3.4	Shqyrtimi i raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe auditimit të financimit të partive politike	Pas momentit të publikimit të Raportit nga ZKA, AKK bënë Shqyrtimin e tyre. Ndërkaq shqyrtimin e Raporteve të Auditimit të financimit të partive politike bëhet gjatë muajit korrik.	DLK	Blerim Kelmendi													K3, K4	1. Numri i raporteve të ZKA të shqyrtuara, 2. Numri i raporteve të auditimit të financimit të partive politike të shqyrtuara	Pa Kosto shtesë	

4 Shqyrtimi i rasteve të konfliktit të interesit																				
Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit			Afati Kohor												Raportimi	Treguesit e performancës	Vlerësimi i resurseve	

			Njësia përgjegjës	Personi përgjegjës	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi
4.1	Pranimi, Evidentimi dhe trajtimi i rasteve të konfliktit të interesit	Inicimi dhe zhvillimi i procedurës për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit ex officio dhe sipas kërkesës apo njoftimit nga palët e treta.	DPKI	Esad Ejupi													K1, K2, K3, K4	1. Numri i rasteve të pranuar, 2. Numri i rasteve të trajtuara, 3. Numri i rasteve të përfunduara.	Pa Kosto shtesë	
4.2	Kontrollimi i formularëve të deklarimit të pasurisë	Kontrollimi i formularëve të deklarimit të pasurisë për identifikim të rasteve të mundshme të konfliktit të interesit	DPKI	Frasher Murtezaj													K3, K4	1. Numri i formularëve të deklarimit të kontrolluar, 2. Numri i rasteve të identifikuar	Pa Kosto shtesë	
4.3	Trajtimi i rasteve për konfliktet e interesit	Agjencia është përgjegjëse për trajtimin e rasteve për parandalimin e konfliktit të interesit.	DPKI	Esad Ejupi													K1, K2, K3, K4	1. Numri i Opinioneve të përgatitura, 2. Numri i Vendimeve të përgatitura, 3. Numri i përgjigjeve të ofruara	Pa Kosto shtesë	
4.4	Mbështetja për Autoritetet Përgjegjëse	Fuqizimi me përvojë dhe praktikë i autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit në institucionet publike: përmes takimeve, trajnimeve.	DPKI	Driton Shala													K1, K2, K3, K4	Numri i këshillave të ofruara për Autoritetet Përgjegjëse dhe numri i takimeve të mbajtura		Buxheti i AKK dhe përkrahja e donatorëve
4.5	Pranimi i Raportimeve nga Autoritetet Përgjegjëse	Përmbledhja e raporteve të dërguar nga Institucionet për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe statusin e trajtimit të tyre.	DPKI	Driton Shala													K1	Numri i rasteve të dorëzuara nga raportimet e Autoriteteve Përgjegjëse	Pa Kosto shtesë	

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia përgjegjëse	Personi përgjegjës	Afati Kohor												Raportimi	Treguesit e performancës	Vlerësimi i resurseve	
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi
5.1	Evidentimi, pranimi ose refuzimi i sinjalizimit	Agjencia pranon rastet e sinjalizimit në mënyra të ndryshme pas plotësimit të kriterëve ligjore, siç është përcaktuar sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.	DMS	Mimoza Limani													Cdo muaj	1. Numri i rasteve të evidentuara, 2. Numri i rasteve të pranuar, 3. Numri i rasteve të refuzuara	Pa Kosto shtesë	
5.2	Procedura e sinjalizimit të jashtëm	Agjencia është përgjegjëse për zhvillimin e procedurës administrative të sinjalizimit të jashtëm në rastet e paraqitura pas plotësimit të kriterëve ligjore, siç është përcaktuar sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.	DLK	Blerim Kelmendi													Cdo muaj	1. Numri i rasteve të proceduara, 2. Numri rasteve të mbyllura	Pa Kosto shtesë	
5.3	Hartimi dhe publikimi i Raportit Vjetor për Sinjalizim	Përmbledhja e raporteve të dërguar nga sektori publik dhe privat për rastet e sinjalizimit, përfshihet në Raportin Vjetor për Sinjalizim i cili publikohet.	DMS	Mimoza Limani													K1	Raporti Vjetor për Sinjalizim ë publikuar	Pa Kosto shtesë	
5.4	Hartimi i Udhëzuesve për mbrojtjen e sinjalizuesve	Hartimi i Udhëzuesit për mbrojtjen e ofruar për personat që dorëzojnë raportimet në interes publik, obligimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit nga aktet e dëmshme dhe të drejtën e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore; Udhëzues për mënyrën e kryerjes se hetimin administrativ. Hartimi i këtyre udhëzuesve bëhet me iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë	AKK, MD	Drejtori i Agjencisë													K1, K2	1.Udhëzuesi për mbrojtjen për mbrojtjen e ofruar për personat që dorëzojnë raportimet në interes publik, obligimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit nga aktet e dëmshme dhe të drejtën e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore i hartuar dhe i aprovuar; 2.Udhëzues për mënyrën e kryerjes se hetimin administrativ i hartuar dhe i aprovuar		Buxheti i AKK dhe përkrahja e donatorëve

6 Avancimi i teknologjisë informative për Agjencinë																				
Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia përgjegjës	Personi përgjegjës	Afati Kohor												Raportimi	Treguesit e performancës	Vlerësimi i resurseve	
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi
6.1	Avancimi i infrastrukturës së teknologjisë informative për Agjencinë	Dizajnimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve për avancimin e rrjetit kompjuterik të Agjencisë	ZMPB	Besnik Dragusha													Çdo muaj	1. Dizajnimi i arkitekturës së rrjetit LAN, 2. Instalimi i pajisjeve, 3. Konfigurimi i pajisjeve. 4. Bartja/Migrimi i të dhënave në serverin e ri		Buxheti i AKK dhe përkrahja e donatorëve
6.2	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	Pranimi i pajisjeve të Teknologjisë Informative dhe iniciimi i procedurave të prokurimit për blerjen e kabinetit dhe UPS-ave për dhomën e serverëve	ZMPB, Menaxheri Prokurimit	Besnik Dragusha													Çdo muaj	1. Hartimi i specifikave teknike, 2. Zhvillimi i procedurave të prokurimit, 3. Furnizimi dhe pranimi i Kabinetit dhe UPSave për dhomën e serverëve	34000	AKK
6.3	Funksionalizimi i Platformës elektronike të Agjencisë	Funksionalizimi i deklarimit online të pasurisë dhe Funksionalizimi i platformës së menaxhimit të rasteve të Agjencisë	AKK														K1, K2, K3, K4	1. Zhvillimi, Testimi dhe implementimi i plotë i Platformës së Deklarimit Online i përfunduar; 2. Zhvillimi, Testimi dhe implementimi i ploti i Platformës së menaxhimit të rasteve të Agjencisë		Donatori - Projekti SAEK III
6.4	Shërbimi online për raportimet e rasteve të korrupsionit	Sistemi automatik i pranimit të informatave në Agjenci, përmes linjës telefonike e cila do të jetë online gjatë gjithë kohës ku do telefonata do të regjistrohet vetëm për përdorim të brendshëm. Të shikohet mundësia e asistencës teknike nga donatorët	AKK															1.Linja telefonike e instaluar; 2.Numri i rasteve të regjistruara.		Donatori - Projekti SAEK III

7 Monitorimi nga Agjencia

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia përgjegjës	Personi përgjegjës	Afati Kohor												Raportimi	Treguesit e performancës	Vlerësimi i resurseve		
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi	
7.1	Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit publik	Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit publik në webfaqen e KRPP-s. Me këtë bëhet Parandalimi i shkeljeve ligjore me elemente korruptive ne aktivitetet e prokurimit si dhe përmirësimi i aktiviteteve të prokurimit publik përmes ofrimit të Opinioneve.	DPK	Florie Retkoceri														Cdo muaj	1. Numri i njoftimeve të kontrolluara në e-prokurim. 2. Numri i rasteve të identifikuar me shkelje të mundshme të LPP, 3. Numri i Aktiviteteve të Monitoruara, 4. Numri i kërkesave të përpiluara për dokumentacion. 5. Numri i Opinioneve të përgatitura dhe të dërguara tek AK, 6. Numri i Opinioneve të pranuar/refuzuara nga AK, 7. Numri i shkresave të dërguara në Departamentin e Hetimeve, Policinë e Kosovës	Pa Kosto shtesë	
7.2	Monitorimi dhe kontaktimi i Zyrtarëve Kontaktues të deklarimit të pasurisë, Zyrtarëve Përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve, dhe Autoriteteve Përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit	AKK monitoron, njofton dhe mbikëqyr Zyrtarët Kontaktues të të gjitha institucioneve përgjegjës për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë. Prandaj, AKK do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me këta zyrtarë për të siguruar një deklaram të pasurisë sa më efikas.	AKK															K1, K2, K3, K4	1. Raportimet e Zyrtarëve Kontaktues	Pa Kosto shtesë	
7.3	Organizimi i trajnimeve për Zyrtarët Kontaktues të deklarimit të pasurisë, Zyrtarët Përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve, dhe Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit	Përgatitja dhe zbatimi i trajnimeve për: 1. Zyrtarët kontaktues (pikat e kontaktit) për deklarimin e pasurisë; konsulta dhe këshilla për zyrtar të lartë publik dhe zyrtar kontaktuese lidhur me deklarimin e pasurisë dhe dhuratave; 2. Zyrtarët Përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizimit; 3. Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit.	AKK	DLK, DPK, DPKI														K3, K4	1. Plani i Trajnimit i përgatitur, 2. Numri i trajnimeve të organizuara me Zyrtarët Kontaktues në fushën e deklarimit të pasurisë, 3. Numri i trajnimeve për Zyrtarët Përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve, 4. Numri i trajnimeve për Autoritetet Përgjegjëse		Buxheti i AKK dhe përkrahja e donatorëve

8 Menaxhimi i Buxhetit dhe i Burimeve Njerëzore																				
Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia përgjegjëse	Personi përgjegjëse	Afati Kohor												Raportimi	Treguesit e performancës	Vlerësimi i resurseve	
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi
8.1	Menaxhimi dhe Administrimi i Buxhetit të AKK-së	Planifikimi me kohë i aktiviteteve të Agjencisë dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nga Agjencia duke u fokusuar në: zvogëlimin e shpenzimeve për vetëm ato çështje që ndërliken direkt me misionin e Agjencisë; zhvillimin e bazës së të dhënave dhe rifreskimi i tyre në kohë reale; si dhe evitimi i mangësive të konstatuara nga auditorët (ZKA dhe Auditori i brendshëm). Përkthimet e materialeve dhe përkthimet simultane	DFSHP	ZKF, ZKA Stafi i lartë													Çdo muaj	1. Hartimi i Planit të rrjedhës së parasë për vitin 2022, sipas kategorive të shpenzimeve 2. Procedimin e pagesave sipas afatit ligjor 3. Plani për zbatimin e rekomandimeve nga auditorët . 4. Përkthimet ne gjuhët zyrtare.	Pa Kosto shtesë	
8.2	Hartimi i Raportit Financiare	Agjencia bënë hartimin e raportit per barazim mujor me thesar, raporti per pasqyrat financiare dhe raporti financiar per Kuvend	DFSHP	ZKF, ZKA													Çdo muaj	1. Barazimi i shpenzimeve të AKK-së me Departamentin e Thesarit – MFT 2. Raporti për Pasqyrat financiare, dhe 3. Raporti Financiar i përgatitur për Kuvend 4. Raportimi i obligimeve të pa paguara ne baza mujore	Pa Kosto shtesë	
8.3	Planifikimi Kërkesave buxhetore	Hartimi i Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve 2023-2025 dhe Hartimi i kërkesave buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore, duke përfshirë planifikimin e buxhetit operativ në sistemin BDMS, dhe planifikimin e projekteve kapitale në sistemin e PIP-it.	DFSHP	ZKF, ZKA Stafi i lartë menaxherial													K2, K4	1. Korniza Afat Mesme e Shpenzimeve 2023-2025 e hartuar, dhe 2. Kërkesat Buxhetore të hartuara sipas Qarkoreve Buxhetore,	Pa Kosto shtesë	
8.4	Regjistrimi i pasurive	Regjistrimi i pasurisë, Procesi i inventarizimit, vlerësimi dhe tjetërsimi, Menaxhimi i Depos, ofrimi i ndihmës logjistike, menaxhimi i veturave.	DFSHP	ZKA , ZKF, Zyrtari i Pasurisë dhe Zyrtari logjistikes													Çdo muaj	1. Regjistri i përgjithshëm i pasurive. 2.Regjisti i pasurive ne vlerë mbi 1000€ 3.Menaxhimi i stoqeve/depos dhe regjistri i tyre, 4. Ofritimi të shërbimeve të logjistikës, 5.Servisimit dhe mirëmbajtja e veturave.	Pa Kosto shtesë	
8.5	Hartimi dhe aprovimi i Planit te prokurimit publik	AQP është përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve të prokurimit publik. Sidoqoftë, Agjencia do të planifikoj për nevojat e saj aktivitetet të cilat do të udhëhiqen më pas nga AQP.	Menaxheri Prokurimit	Dardan çela														Plani i Prokurimit Publik i hartuar dhe i aprovuar	Pa Kosto shtesë	
8.6	Menaxhimi i Buxhetit dhe i Burimeve Njerëzore	Kjo përfshinë Menaxhimin e sistemit të pagave; Menaxhim i SIMBNJ-së; Menaxhimi i SMAED-së; Menaxhimi i	Menaxheri i Personelit	Sebahate Jonuzi													Çdo muaj	1.Përgatitja e Listave të pagave; 2.Menaxhimi i SIMBNJ-së;	Pa Kosto shtesë	

		SMVP-së; Menaxhimi i Sistemit të HRMIS; Menaxhimi dhe mirëmbajtja e dosjeve personale për zyrtarët e AKK-s; Përpilimi i raportit të vlerësimit për zyrtarët e AKK-së.																3.Menaxhimi i SMAED-së. 4.Menaxhimi i SMVP-së. 5.Menaxhimi dhe mirëmbajtja e dosjeve personale për zyrtarët e AKK-s. 6.Përpilimi i raportit të vlerësimit për zyrtarët e AKK-së.		
8.7	Ri-organizimi i strukturës së Agjencisë	Vlerësimi i nevojave, Hartimi dhe Miratimi i strukturës së Agjencisë.	AKK															1. Raporti i vlerësimit të strukturës së Agjencisë nga eksperti ndërkombëtare, 2. Përgatitja e Projekt Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë e miratuar, 3.Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë e miratuar		Donatori - Projekti SAEK III
8.8	Hartimi i Planit të Performancës dhe Planit të Punës së Agjencisë	Hartimi i Planit të Performancës së Agjencisë dhe Planit të Punës sipas ligjit të administratës shtetërore.	AKK															1. Plani i Performancës për vitin e ardhshëm i përgatitur dhe aprovuar, 2. Plani i Punës së Agjencisë i përgatitur dhe aprovuar	Pa Kosto shtesë	
8.9	Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit Vjetor të Punës për vitin 2022	Çdo vit, Agjencia përgatit raportin vjetor të punës për vitin paraprak. Kjo bëhet sipas Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsion. Ky raport i dorëzohet Kuvendit më së largu deri më datën 31 mars.	AKK															Raporti Vjetor i Punës së AKK për vitin 2022 i dorëzuar në Kuvend	Pa Kosto shtesë	
8.10	Shqyrtimi dhe vlerësimi i nevojave për hapësirat e arkivit të Agjencisë	Agjencia krijon grupin punues për vlerësimin dhe shqyrtimin e hapësirave fizike dhe nevojave ligjore të arkivit të Agjencisë	AKK															Raporti i përgatitur nga Grupi Punues		Buxheti i AKK dhe përkrahja e donatorëve